

VENDIM
Nr.796, datë 8.9.2010

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.787, DATË 14.12.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE DHE TË MASËS SË NDIHMËS EKONOMIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10, 19, pika 3, 20, pika 2, 29, pika 10, e 35, të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.787, datë 14.12.2005 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas shkronjës “ç” të pikës 1, shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:
“d) Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror deri në çastin e punësimit të tyre.”.
 2. Pas pikës 7 shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:
“7/1.Viktima e trafikimit paraqet dokumentacionin e mëposhtëm:
a) Kopjen e noterizuar të letërnjoftimit;
b) Vërtetimin si punëkërkues i papunë, të lëshuar nga zyra përkatëse e punësimit;
c) Vërtetimin e daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror për viktimat e trafikimit.”.
 3. Në pikën 14, pas fjalëve “... apo anëtarëve të saj...” shtohen “...dhe kategorive përfituese sipas pikës 1 të vendimit...”.
 4. Pas pikës 18 shtohet pika 18/1, me këtë përmbajtje:
“18.1 Masa e ndihmës ekonomike për viktimat e trafikimit është 3000 (tre mijë) lekë në muaj. Kjo ndihmë ekonomike përfitohet pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror, deri në çastin e punësimit të tyre.”.
 5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1 tetor 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha